



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit

S- 046

Prishtinë, më 10 nëntor 2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
10 NËNTOR 2008**

Seancën e kryesoi Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi Eqrem Kryeziu, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 89 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se në bazë të Vendimit të Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin lidhur me të, sipas procedurës së veçantë, datë 15 shkurt 2008, seanca e sotme plenare do të zhvillojë punimet me këtë

R e n d d i t e:

I. Shqyrtimi i dytë i Grupit të shtatë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës,

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektkodit doganor dhe të akcizave të Kosovës.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Komisionit ad-hoc që para deputetëve të Kuvendit t'i arsyetojë rekomandimet për projektligjet.

Deputeti Ramadan Gashi, i arsyetoi Rekomandimet e Komisionit ad-hoc për tri projektligjet dhe për Projektkodin doganor dhe të akcizave të Kosovës.

Komisioni Ad hoc, në bazë të vendimit të Kuvendit të Kosovës, datë 15 shkurt 2008, në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2008, ka shqyrtuar grupin e shtatë të projektligjeve të miratuara, në parim, në seancën plenare të mbajtur më 7 nëntor 2008, dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Komisioni, njëzëri vendosi t'i rekomandojë Kuvendit që ta miratojë Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në formën e propozuar.

Komisioni, njëzëri vendosi t'i rekomandojë Kuvendit që ta miratojë Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor, me amendamentin e propozuar.

Komisioni, më 7 vota "për" dhe një abstenim, vendosi t'i rekomandojë Kuvendit që ta miratojë Projektkodin doganor dhe të akcizave të Kosovës, me amendamentin e propozuar.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 79;

Kundër----- 2.

Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ta miratojë atë në formën e propozuar.

Kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 82;
Kundër-----1.
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë atë, me një amendament.

Kryetari hodhi në votim amendamentin e propozuar nga Komisioni ad-hoc në Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor.

Kuvendi, me shumicë votash, miratoi amendamentin: 1.

Pastaj, Kryetari e hodhi në votim projektligjin në tërësi, me amendamentin e miratuar. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 69;
Kundër----- 4.
Abstenime-----13.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektkodit doganor dhe të akcizave të Kosovës.

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektkodin doganor dhe të akcizave të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë atë me një amendament.

Kryetari hodhi në votim amendamentin e propozuar nga Komisioni ad-hoc në Projektkodin doganor dhe të akcizave të Kosovës.

Kuvendi, me shumicë votash, miratoi amendamentin: 1.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim projektkodin në tërësi, me amendamentin e miratuar.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 63;
Kundër----- 12.
Abstenime-----6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Kodin doganor dhe të akcizave të Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 11:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale